

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-46/07-07

Prishtinë, më 16 mars 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 83 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 22 shkurtit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendbanim dhe vendqëndrim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor,
6. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë,
7. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave,
8. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e gjyqtarëve dhe
9. Shqyrtimi i Propozimprogramit të punës së Kuvendit për vitin 2007 dhe të kalendarit vjetor.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, Grupi Parlamentar i LDK-së ka parashtruar një mocion me shkrim që në seancën e sotme të shqyrtohet edhe propozimi i Qeverisë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar i LDK-së, para deputetëve të Kuvendit e arsyetoi propozimin për shqyrtimin e Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar i LDK-së që në seancën e sotme të shqyrtohet edhe Propozimvendimi i Qeverisë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Teuta Sahatqija, kryetare e Grupit Parlamentar të ORA-s, shprehu pakënaqësi për sekretarinë e Kuvendit, sepse nuk ua kishte shpërndarë deputetëve të Kuvendit një material të dorëzuar nga OJQ-ja "Çohu". Ajo kërkoi që kjo çështje të shqyrtohet në seancën e sotme.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetares së Grupit Parlamentar të ORA-s.

Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi kërkesën e kryetares së Grupit Parlamentar të ORA-s.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kolçaku** kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet edhe për çështjen e vaksinave që janë ndalur në kufi. Dogana nuk i lejon vaksinat të hujnë pa u doganuar, kurse Qeveria nuk ka ndarë mjete për doganimin e tyre.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së tha se mbështet kërkesën e deputetës Mulhaxha, por para se kjo çështje të shqyrtohet në Kuvend, Ministria e Shëndetësisë duhet të përgatitë një informatë me shkrim lidhur me të.

Deputeti **Gani Koci** kërkoi që seancën e sotme të mos e drejtojë kryetari i Kuvendit, z. Kolë Berisha.

Kryetari e hodhi në votim kërkesën e deputetit Koci.

Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi kërkesën e deputetit Koci.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 22 shkurtit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 22 shkurtit 2007 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, lidhur me mosmbajtjen e ligjëratave me rregull në disa fakultet të Universitetit të Prishtinës dhe të shtyrjes së afatit të provimeve pa arsye.

Kryeministri **Agim Çeku** e kishe autorizuar ministrin e MASHT për t'iu përgjigjur kësaj pyetje.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi

Deputeti **Kamber Kamberi** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me Projektin për Hidrosistemin në Ponoshec.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kamberi.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me Planin strategjik për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për dhënien me koncesion të Aeroportit të Prishtinës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha..

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me zbatimin e marrëveshjes ndërmjet New Co Feronikel dhe AKM-së.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha..

Deputeti **Ibush Jonuzi** i parashtrroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me përgatitjet për fillimin e punimeve për ndërtimin e autostradës Merdar - Morinë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Jonuzi.

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtrroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me ndërtimin e dy rrugëve në komunën e Ferizajt.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Aliaj.

Deputetja **Selvije Halimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me ndërprerjen e dhënies së pensioneve.

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Halimi.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** i parashtrroi pyetje zëvendësministrit të Bujqësisë lidhur me shfrytëzimin racional të pyjeve në komunën e Deçanit.

Zvendësministri **Tomë Hajdaraj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, **Blerim Kuçi**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim zëvendësministri **Kuçi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit të, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Kuçi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: **Agim Krasniqi** në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sokol Bashota** në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Naim Maloku** në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Nazim Jashari** në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s dhe **Mahir Yagcilar** në emër të Grupit Parlamentar 6 plus. Në diskutim morën pjesë edhe këta deputetë: **Ramadan Kelmendi**, **Zyhrije Maloku**, **Milazim Haliti**, **Nexhat Rexha**, **Teutë Sahatqija**, **Fetah Berisha** dhe **Naxhije Doçi**, që i janë bashkangjitur transkriptitit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 73;

Kundër----- 0;

Abstenime-----03.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për vendbanimin dhe vendqëndrimin.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Siguri - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

Kryetari dha pauzë për drekë.

Pas pauzës seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Merxhan Abdyl**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.

Në vazhdim, zëvendësministri **Abdyl** shpjegoi pengesat që kishin hasur gjatë zbatimit të këtij projektligji, si dhe mënyrat për tejkalimin e tyre.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Abdyli**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Shaban Halimi në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Selvije Halimi në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Mazllom Kumnova në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së Gazmend Muhaxheri, Xhezair Murati në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, si dhe deputetët Nekibe Kelmeni dhe Xhelal Canziba, që i janë bashkangjitur trasnkriptitit.**

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 75;
Kundër----- 0;
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimin hapësinor.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i informatës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit lidhur me përzgjedhjen e operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë

Kryesuesi e ftoi propozuesin e mocionit ta marrte fjalën.

Deputeti **Demir Limaj** në emër të 9 deputetëve – parashtrues të këtij mocion - tha se ART-ja ka dalë mbi çdo institucion dhe të gjitha analizat tregojnë se ajo ka bërë shkelje të Ligjit në fushën e telefonisë mobile në Kosovë dhe shkelje të interesit publik gjatë tenderit të parë dhe të dytë për operator të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

Nuk ka pasur transparencë të brendshme për ofertuesit dhe për publikun, lidhur me identitetin e personave fizikë dhe juridikë ku janë vërejtur kombinime antiligjore të një personi fizik apo juridik, për shembull duke konkurruar me dy konsorciume me emra të ndryshëm dhe me pronarë e investues të njëjtë.

ART ka dështuar të menaxhojë një proces të drejtë, të saktë, jo diskriminues dhe përshkrues të përzgjedhjes së licencës në kuptim të neneve 22 dhe 36 të Ligjit mbi Telekomunikacionin e Kosovës. ART nuk ka qenë transparente as me ofertuesit dhe as me publikimin e rezultateve të vlerësimit kur e ka zgjedhur fituesin e parë, por më tepër ua ka refuzuar edhe ofertuesve që janë ankuar gjatë procesit.

Kreu i ART-së duhet që Kuvendit të Kosovës t'i ofrojë shpjegime të sakta dhe të argumentuara se si dhe pse kanë ndodhur këto lëshime kaq të rënda dhe me pasoja për gjithë procesin.

ART-ja me ligj ka qenë e obliguar ta arkëtojë taksën prej ofertuesit të përzgjedhur që ka dështuar ta paguajë çmimin e licencës. ART-ja ka dështuar që në emër të dështimit të

ofertuesit të parë të arkëtonte shumën prej miliona eurosh në buxhetin e Kosovës. Kreu i ART-së duhet t'i japë shpjegime Kuvendit të Kosovës pse kjo ka ndodhur?

Në fund të fjalimit të tij deputeti Limaj tha se pas debatit që do të zhvillohet nga deputetët e Kuvendit, do t'i paraqesë rekomandimet për të dalë nga kjo gjendje.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për informatën e ART-së dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së - **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së - **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së - **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s - **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus - **Mahir Yagcilar** në emër të Grupit Parlamentar për Integrim - **Ferid Agani**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Ministri i Transportit dhe i Postëtelekomunikacionit, z. **Qemajl Ahmeti**, shpjegoi përgjegjësitë që i ka pasur kjo ministri gjatë përgatitjes së tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile në Kosovë.

Meqë kryeministri dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës (përveç ministrit Qemajl Ahmeti) dhe kryesuesi i ART-së nuk ishin të pranishëm në seancë, kryesuesi propozoi të ndërpriten diskutimet për këtë temë dhe të vazhdojnë në seancën tjetër kur të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e qeverisë dhe të ART-së.

Pas këtyre diskutimeve Kuvendi nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Bordi i ATR-së t'i paraqet Kuvendit të dhëna shtesë për pjesëmarrësit në tender dhe vlerësimet e pikave të ofertuesve lidhur me procedurën e përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë.
2. Kërkohet që në seancën plenare të 22 marsit 2007 të marrin pjesë kryeministri i Kosovës, ministri për telekomunikacion, kryesuesi i ART-së, si dhe të gjithë anëtarët e Bordit.

7. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetonte propozimin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Qemajl Ahmeti**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi Propozimvendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave.

Opinione dhe vërejtje për këtë propozimvendim dhanë këta deputetë: **Fadil Kryeziu**, **Selvije Halimi**, **Ramadan Kelmendi** dhe **Safete Hadërgjonaj**, që janë pjesë e transkriptit.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----46;

Kundër----- 24.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave emërohen këta kandidatë:

1. Bahri Hyseni, anëtar,
2. Hajdin Ramadani, anëtar,
3. Islam Çeku, anëtar,
4. Nazmi Pllana, anëtar,
5. Qemajl Smajli, anëtar dhe
6. Lubisha Shipiq, anëtar.

2. Mandati i të emëruarve zgjat dy (2) vjet.

8. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e gjyqtarëve

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtuese ta arsyetojë rekomandimin.

Deputeti **Sadudin Berisha**, nënkryetari i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtuese e arsyetoi rekomandimin e Komisionit para deputetëve të Kuvendit dhe i ftoi ata ta miratonin këtë rekomandim.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar tha se e mbështet rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtuese.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** tha se është kundër emërimit të kandidatëve të rekomanduar për gjyqtar.

Deputeti **Berat Luzha** tha se Kuvendi duhet ta refuzojë rekomandimin për emërimin e këtyre gjyqtarëve.

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin për emërimin e gjyqtarëve. Rezultati ishte si vijon:

Për-----32;

Kundër-----36;

Abstenime----- 7.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi i Kosovës nuk e mbështet rekomandimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e këtyre gjyqtarëve:

1. Vatton Dërguti, gjyqtar në Gjykatën Komunale të Prizrenit,
2. Rrahman Asllani, gjyqtar në Gjykatën Komunale të Prizrenit dhe
3. Vasilije Arsiq, gjyqtar në Gjykatën Komunale të Gjilanit.

2. Vendimi i parashtrohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

9. Shqyrtimi i Propozimprogramit të punës së Kuvendit për vitin 2007 dhe të kalendarit vjetor

Kryesuesi i informoi deputetët e pranishëm për Propozimprogramin e punës së Kuvendit të vitit 2007 dhe për kalendarin vjetor të seancave plenare, të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare.

Opinione dhe sugjerime për Përopozimprogramin e punës së Kuvendit të vitit 2007 dhanë këta deputetë: **Emrush Xhemajli, Alush Gashi, Gjylnaze Sylja, Ramadan Kelmendi, Hurishahe Hulaj, Kamber Kamberi, Ibush Jonuzi, Xhevat Bislimi, Agim Krasniqi, Selvije Halimi, Xhezair Murati, Nekibe Kelmedni, Fatmire Mulhaxha, Ferid Agani dhe Berat Luzha**, që janë pjesë e transkriptit.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim Propozimprogramin e punës së Kuvendit për vitin 2007 dhe kalendarin vjetor. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----58;

Kundër----- 6.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i miratoi Programin e punës së Kuvendit për vitin 2007 dhe kalendarin vjetor të seancave plenare, të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare.

10. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e dy anëtarëve në Bordin Drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit për Propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës dhe për dy kandidatët e propozuar për anëtar të Bordit Drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës.

Deputeti **Xhevat Bislimi** pati vërejtje për kandidatin Isa Mustafa.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozimvendim e Qeverisë së Kosovës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----38;

Kundër----- 26;

Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi i Kosovës, për anëtarë të Bordit Drejtues të Autoritet Qendror Bankar të Kosovës, i miraton këta kandidatë:

1. Isa Mustafa,
2. Afrim Maloku.

2. Vendimi i procedohet PSSP-së për veprim të mëtejshëm.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale